

VENDIM
Nr. 594, datë 9.10.2018

**PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES
TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 23, datë 16.1.2019; nr. 371, datë 29.5.2019; nr. 648, datë 2.10.2019; nr. 773, datë 30.9.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, si më poshtë vijon:

- Znj. Dajna Sorensen, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- Znj. Adea Pirdeni, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për drejtësinë;
- Znj. Mira Hoxha, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
- Z. Kostandin Shkurti, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Znj. Ornela Çuçi, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin;
- Znj. Kozeta Angjeliu, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturën.
- Znj. Anila Hyka Smorgrav emërohet si përfaqësuese nga Këshilli Koordinues i Diasporës.

2. Emërohet znj. Dajna Sorensen, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, kryetar i Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama